

Република Северна Македонија
ОПШТИНА ЖЕЛИНО
Ж Е Л И Н О



Republika e Maqedonisë Veriut
KOMUNA E ZHELINËS
Z H E L I N Ë

PROPOZIM - PROGRAM

për aktivitetet sportive dhe kulturore në
Komunën e Zhelinës për vitin 2021-të

Numri 08-_____

Zhelinë

Përgaditi: Saubi Avziu
Lazim Idrizi

PROPOZUES
KRYETARI
Blerim Sejdiu

Në bazë të nenit 22 paragrafi 5 dhe 6, të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gazeta zyrtare e RM-së“ nr.05/2002), dhe Ligjit për sport („Gazeta zyrtare e RM-së“ nr.29/2002, 66/2004, 81/2008, 18/2011, 51/2011, 64/2012, 148/2013, 187/2013, 42/2014, 138/2014, 177/2014, 72/2015 dhe 153/2015), Këshilli i komunës së Zhelinës në seancën e mbajtur me datë: --.--.2020, miratoi:

PROGRAM

Për aktivitetet sportive dhe kulturore në Komunën e Zhelinës për vitin 2021.

I.HYRJE

Komuna e Zhelinës në pajtueshmëri me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Ligjin për kulturë dhe sport,përgatitën Programë për aktivitetet në këto lëmi, me çka sportit dhe kulturës i jepet rëndësia që i takon për zhvillimin shoqërorë social të të rinjëve dhe nxënësve të komunës. Gjatë hartimit të Programës janë marrë parasysh drejtimit dhe synimet e decentralizimit të sportit nga niveli qendrorë në atë lokal.

Sporti në komunën e Zhelinës ka traditën e vet,vlera të dëshmuara, posedon fushë sporti në pronë të komunës, sallë sportive pronë e sh.f.k.,Luigj Gurakuqi,,ku mund të organizohen manifestime kulturore,tradicionale dhe sportive, quadro profesionale dhe gjithashtu qytetarë që e duan dhe e respektojnë sportin. Komuna e Zhelinës, zhvillimin e sportit mund ta arrijë duke praktikuar dhe mundësuar kushte elementare infrastrukturore sportive në të gjithë teritorin e komunës, ku sporti dhe kultura të zënë vend të rëndësishëm dhe të dallueshëm në arsim dhe jetën e përditëshme të të rinjtë.

Sipas Ligjit për NJVL, neni 22, pika 5 dhe 6 parashikohet:

- Zhvillimi i sportit masiv dhe aktiviteteve rekreative;
- Organizimi i manifestimeve dhe garave sportive;
- Mirëmbajtja riparimi dhe ndërtimi i objekteve sportive;
- Përkrahjen e shoqatave sportive;
- Inicimi i formave të ndryshme për zhvillimin e kulturës;
- Përkrahja e manifestimeve të ndryshme kulturore;
- Mirëmbajtja dhe finansimi i objekteve dhe projekteve që kanë të bëjnë me kulturën, folklorin,traditat, artizanatet dhe të ndryshme.

II. QËLLIMET

Qëllimet themelore të këtij Programi janë:Promovimi i mundësive të komunës së Zhelinës që të jetë nikoqir i manifestimeve të veçanta sportive dhe kulturore të rangut rajonal – nacional, dhe përkrahjen e iniciativave që ndërmeren në këtë plan, rritje e përfshirjes së të rinjëve në sport dhe aktiviteteve sportive – rekreative nëpërmjet zhvillimit të sportit shkollorë, duke siguruar përkrahje të aktiviteteve rekreative, kulturore dhe garave të ndryshme të të rinjëve në komunë, si dhe

përkrahje të aktiviteteve për sport dhe rekreacion të personave me nevoja të veçanta si dhe zhvillimin e realizimin e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e sportit dhe kulturës.

III. AKTIVITETE

Aktivitetet në fushën e sportit dhe kulturës, komuna e Zhelinës do t'i zhvillojë në drejtim të përkrahjes, përforcimit dhe ndihmës në realizimin e qëllimeve të këtij Programi dhe kohën e realizimit.

Në këtë drejtim do të zhvillohen aktivitetet për :

- Përkrahje të manifestimeve kulturore dhe sportive, tradicionale me interes tek nxënësit dhe qytetarët; (*sipas nevojës*).
- Pjesëmarrje në organizimin e garave rajonale;
- Inicim dhe realizim i projekteve për krijimin e kushteve optimale për aktivitete sportive, respektivisht ndërtimin e infrastrukturës sportive nëpër shkolla; (*permanente*).
- Pjesëmarrje në publikimin e broshurave, punimeve shkencore të ndryshme për rëndësin e sportit dhe kulturës në komunën e Zhelinës; Zgjedhja e sportistit të vitit;
- Përkrahje e shoqatave komunale jo qeveritare me karakter edukativ kulturor dhe sportiv;
- Përkrahje e klubeve sportive që bëjnë aktivitete në komunën e Zhelinës; (*sipas nevojës*)
- Aktivitete sportive –rekreative, rekreacion sportiv i qytetarëve;
- Bashkëpunimi i komunës së Zhelinës me Federatat sportive si: Federata e Futbollit të Maqedonisë së Veriut, Agjensioni për rini sport dhe Kulturë, Lidhja futbollistike komunale Tetovë, Liga e futbollit për fëmijë perendim si dhe federatave tjera sportive në R e Maqedonisë së Veriut;
- Regullimi i fushës ndihmëse të futbollit, mirëmbajtja dhe sanimi i dëmeve të stadiumi aktual i futbollit pronë e komunës së Zhelinës;
- Përkrahje financiare e Klubeve - komunal të Futbollit - (*sipas nevojës*)

Në bashkëpunim me Kryetarin e komunës, Këshillin e komunës, dhe sektorin e arsimit rinisë sportit dhe kulturës të bëhet i mundëshëm realizimi i qëllimit të kësaj programe.

IV. PLANI FINANCIAR

Aktivitetet e komunës së Zhelinës në lëminë e sportit dhe kulturës, të përcaktuara me këtë Programë do të financohen nga mjetet e buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2021-të, që janë të përcaktuara për këtë qëllim si dhe nga donacione dhe sponsorime të tjera të parapara me ligj.

Mjete nga buxheti i komunës së Zhelinës për vitin 2021 programi sport–kulturë

Nr.	Aktivitetet	Vlera
1	Përkrahje financiare të manifestimeve kulturore dhe sportive, tradicionale me interes tek nxënësit, përkrahje sportit shkollorë (regjistrimi i klubeve sportive shkollore), garave sportive komunale me pjesëmarrje të K.S.SH, në disiplinat Futboll, Hendboll, Volejboll, Basketboll, Atletik etj, si dhe pjesmarjen e K.S.SH, në garat rajonale.	350.000,00 den
2	Mirëmbajtja sanimi i dëmeve te stadiumi i futbollit dhe fushave tjera sportive.	100.000,00 den
3	Bashkëpunimi i komunës me MASH si dhe me federatat sportive të RMV-së, si FFM, LFK, Liga e futbollit për fëmijë etj.	25.000,00 den
4	Aktivitete sportive – rekreative, rekreim sportiv i qyteterëve të komunës së Zhelinës.	30.000,00 den
5	Përkrahje financiare klubeve aktive sportive, që bëjnë aktivitete në komunën e Zhelinës	25.000,00 den
6	Përkrahje e shoqatave komunale, me karakter kulturor, dhe sportiv.	60.000,00 den
7	Dokumentacion teknik për sallë sportive në f.Grupçin	120.000,00den
8	Rikonstruim i fushës së futbollit në sh.f.k.,Fan Noli,,f.Trebosh	1.147.892.00.den
9	Dokumentacioni teknik për fusha sportive te vogla	30.000.00 den
10	Ndërtimi i fushës së sportit në f.Çiflik	150.000.00 den
11	Këndi i lojrave që kan ngelur.	
12	Përkrahja e festivalit për trashëgimi kulturore	1.200.000.00 den

Vlera TOTALE _____ 2.887.892.00 den

- Në raste të jashtëzakonshme,për shembull kur klubi sportiv gjendet në gjendje të rëndë financiare ose ka ambicie për të kaluar në një kategori më të lartë, Këshilli ka të drejtë të posaçme për të vendosur për pagesë të një shume më të lartë nga të parashikuarat.

V.FORMA TJERA PËR PËRKRAHJEN E MANIFESTIMEVE SPORTIVE DHE KULTURORE

Manifestimet tjera sportive dhe kulturore me rëndësi për realizimin e qëllimeve të Programit, do të përkrahen, ndihmohen në veçanti nëpërmjet formave tjera të aktiviteteve si:

- Patronazh nderit të komunës së Zhelinës;
- Shpërndarja e dhuratave, shpërbilimeve etj;
- Pjesëmarrje protokollare.

VI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Kryetari i komunës së Zhelinës kujdeset dhe siguron implementimin e kësaj Programe.

Komisioni amë dhe ai i posaçëm, ndjek implementimin e programës, mer iniciativa, jep mendime dhe propozon vendime në lidhje me qëllimet e Programës.

Kjo Programë hyn në fuqi me ditën e sjelljes dhe shpallet në „Gazetën zyrtare„ të komunës së Zhelinës.

Nr.08- _____

Zhelinë

Këshilli i komunës së Zhelinës
Kryetar
Liridon Useini